



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО	
KOMUNA E VUSHTRISË - КОМУНА ВУШТРИН	
01 Nr. / Br	223 / 17
Nr. i fq. / Br. sh	- 14 -
Data / Datum	27. 07. 2017
VESHITJE / ВУШТРИН	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

**PROCESVERBAL**  
**NGA MBLEDHJA E -VI- (E GJASHTË) E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS**  
**SË VUSHTRISË, MBAJTUR MË 29 QERSHOR 2017**

*Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:10.*

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Gentiana Rama, Habib Mustafa, Habibe Gërxfhaliu, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rrahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Syzana Sylja, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

**Munguan: Hysni Gërguri dhe Ilmi Azemi.**

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe Kryetari i komunës, Nënkryetari i komunës, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapë dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe hapë debatin për rendin e ditës.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – propozoi një pikë shtesë për futje në rend të ditës në pikën në të ndryshme, propozim-vendim për caktimin e lokacionit për ndërtimin e lapidarit të UÇK-së. Lidhur me këtë propozim ai dha një arsyetim kronologjik sa u përket fazave të zhvillimeve për këtë projekt.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – pyeti se përse është festuar “Dita e çlirimit të qytetit të Vushtrisë më datë 16 qershor, kur dihet fakti se kjo datë është 17 qershor dhe kështu kësaj feste po i humbet vlera. Pastaj shprehu ankesa sa i përket organizimit të manifestimit për ditën ZOSH, si dhe njoftoi për çështjen e komisionit për caktimin e lokacionit për vendosjen e lapidarit të UÇK-së.

*Në përfundim të diskutimeve rreth rendit të ditës, Kuvendi në mënyrë “unanime” aprovoi këtë:*

**REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 25.05.2017;
2. Shqyrtimi i Draft-kornizës afatmesme (KAB) 2018-2020;
3. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shndërrim të projektit “ndërtimi i kanalizimeve” në projekt dyvjeçar dhe përcaktimi i vijave të ndërtimit të kanalizimeve;

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve për realizimin e projektit për ndërtim të shtëpisë për banim nga kategoria për subvencione dhe transfere në bashkëfinancim me SHBK “Nënë Tereza”;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale;
8. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit “Azem dhe Shotë Galica” në Vushtrri;
9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë;
10. Shqyrtimi i Informatës për shfrytëzimin e pasurisë së komunës;
11. Të ndryshme.
  - a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e shtëpive në komunitet;
  - b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit;
  - c). Shqyrtimi i petitionit të banorëve të fshatit Bukosh;
  - ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e rrugës me emrin e Zeqir Gubetinit;
  - d). Shqyrtimin i Propozim-vendimit për ndërtimin e lapidarit të UÇK-së në fshatin Stroc.

1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 25.05.2017

*Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” të tjerat “abstenim” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit e datës 25.05.2017.*

2. Shqyrtimi i Draft-kornizës afatmesme (KAB) 2018-2020

**Isuf Jashari, drejtor i DBF-së** - paraqiti sqarime hyrëse profesionale, lidhur me draft-kornizën afatmesme buxhetore 2018-2020.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se në këtë dokument d.m.th të Draft-kornizës afatmesme duhet të kemi shifra të sakta, si për popullatën ashtu edhe për kategoritë tjera të rëndësishme për komunën tonë. Pastaj duhet të kemi planifikim real të mjeteve financiare sa i përket punëtorëve të arsimit për plotësimin e obligimeve që dalin nga marrëveshja kolektive. Gjithashtu duhet të kemi planifikim real sa i përket projeksioneve dhe kërkesave me mundësitë financiare të komunës që do të futen në buxhetin e komunës për vitin 2018. Në vazhdim vlerësoi se duhet të kemi specifikim të projekteve si të rrugëve, kanalizimeve, urave dhe shtretërve të lumenjve, të cilat janë dhënë në mënyrë kumulative. Në fund përsëriti si edhe herëve tjera se duhet të kemi zhvillim harmonik të komunës në rajonet ku tatimi paguhet në vlera më të larta, aty të kemi më tepër investime kapitale.

**Agim Bregaj, anëtar i kuvendit** – pyeti se cilat janë prioritetet e Drejtorisë së Shëndetësisë në draft-kornizën buxhetore sa i përket fushës së shëndetësisë në komunën tonë, si dhe pyeti se cilat janë politikat me prioritet në Komunën e Vushtrrisë për identifikimin dhe radikimin imediat të sëmundjeve në komunën tonë.

**Bahrije Pllana, anëtare e kuvendit** – tha se plani i buxhetit për vitin 2018 do të hartohet në bashkëpunim me të gjithë akterët, duke realizuar dëgjimet buxhetore dhe duke i marrë kërkesat e qytetarëve të cilat do të inkorporohen në këtë draft-buxhet. Pastaj ajo propozoi që në Vushtrri në rrugën “Vicianë” të bëhet rregullimi i kanalizimit në gjatësi prej 770 m, mandej në fshatin Shtitaricë të ndërtohet rruga në vendin e quajtur tek “Çezma e zotënisë”, ndriçimi i fshatit Shtitaricë, mandej ndërtimi i rrugës dhe trotuarit nga Ura e gurit e deri tek stacioni hekurudhor, pastaj rruga “Rizah Pllana” në gjatësi 400 m të rregullohet në asfalt, si dhe të rinovohet shkolla

e mesme "Lutfi Musiqi". Në fund tha se duhet të vazhdohet me rregullimin e shtrati të lumit "Tërrstena".

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – pyeti se Drejtoria e Financave a është konsultuar me drejtoritë tjera të linjës dhe se a ka marrë kërkesa nga këto drejtori. Tutje shtoi se në kuadër të këtyre konsultimeve me drejtoritë tjera do të bëhej identifikimi i nevojave që janë me prioritet. Pastaj vlerësoi se nuk është mirë që janë zvogëluar mjetet financiare nga granti specifik i shëndetësisë nga 50.000€ në 30.000€. Mandej shtoi se është e nevojshme që të procedohet për ndryshim Rregullorja për ndarjen e subvencioneve. Në këtë kontekst gjykoj se deri më tani nuk kemi pasur ndarje racionale të subvencioneve dhe se në gjysmën e parë të vitit të gjitha mjetet janë shpenzuar dhe drejtoria ka mbetur pa "asnjë cent" për ofrimin e ndihmës financiare për raste të ndryshme. Andaj lidhur me këtë propozoi që kjo rregullore në afatin sa më të shpejt të procedohet për kuvend dhe e njëjta të aprovohet. Lidhur me investimet kapitale projektet për ndërrimin e dymyreve dhe dritareve dhe rinovimet e QMF-ve, ceku se drejtoria kompetente është mirë që të marrë numrin e saktë të qendrave, të cilat janë rinovuar nga Drejtoria e Prokurimit, dhe apostrofoi se Qendra e Mjekësisë në Novolan nuk mund të rregullohet pasi që ai objekt është shumë i dëmtuar. Rritja e të hyrave vetanake në lëmin e shëndetësisë në vlerë prej 60.000 € nuk është e drejtë pasi nuk është i sigurt që këto mjetet do të mund të inkasohen në tërësi. Subvencionimi i bujqësisë, është mirë që po ndodh, por përsëriti se do të ishte mirë që të vlerësohej efekti praktik në terren i këtyre subvencioneve, për faktin se shpeshherë këto subvencione nuk e kanë dhënë rezultatin e duhur.

**Qerim Selimi, anëtar i kuvendit** – tha se në kuadër të buxhetit duhet të futet si projekt ndërtimi i shkollës fillore në fshatin Beçiq, si dhe meremetimi i shkollës "Naim Frashëri"

**Skënder Hajrizi, banor i fshatit Sllatinë** - kërkoi që të rregullohet rruga në fshatin Sllatinë, dhe apeloj që materiali për shtrimin e asaj rruge mos të jetë i cilësisë së dobët, i cili po merret në fshatin Sllatinë.

**Abit Abit, ZKF** - paraqiti sqarime lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore për vitin 2018-2020 dhe paraqiti përgjigje në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se korniza afatmesme e shpenzimeve është një dokument ku në vija të përgjithshme bëhet planifikimi i buxhetit të komunës. Tutje shtoi se për vitin 2018 kemi ulje për afro 40.000 € të të hyrave vetanake dhe kjo mund të vlerësohet si një përmirësim i gabimit që është bërë nga Ministria e Financave. Mandej tek kategoria e subvencioneve mund të thuhet se komuna jonë është e ndëshkuar ku shuma për vitin 2018 është 218,000.00 €, dhe kjo krahasuar me komunat tjera që kanë afërsisht numër të njëjtë të banorëve e të cilave iu janë ndarë shumë më tepër subvencione del që kemi diskriminim nga niveli qendror për komunën tonë. Në vitin 2014 komunës tonë i janë ndarë rreth 270,000.00 € subvencione, kurse vite më vonë ato mjete ishin zvogëluar nga niveli qendror në bazë të kriterëve që askush nuk i ka të qarta. Ajo çka ai e vlerësoi si pozitive është rritja e buxhetit për vitin 2018 për afro 1,3000.00 € krahasuar me vitin që jemi. Lidhur me përgjigjen e qytetarit Skënder Hajrizi ceku se rruga në fshatin Sllatinë do të ndërtohet. Në fund tha se kah muaji gusht do të ishte mirë që bëhej një takim me të gjitha subjektet politike, ku do të analizoheshin të gjitha kërkesat e bëra nga bashkësitë lokale dhe qytetarët e të cilat do të inkuorohen në projekt-buxhetin e komunës për vitin 2018.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – pyeti se a janë marrë kërkesat nga drejtoritë gjegjëse për t'i inkuoruar në kornizën afatmesme buxhetore, për faktin se sipas tij nuk ka ndodhur një gjë e tillë. Pastaj pyeti se drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë a ka qenë në vizitë të objekteve, të cilat do të rinovohen, për faktin se janë paraparë shuma bukur të larta për rinovimin e këtyre objekteve shëndetësore. Mandej shtoi nevojën për furnizim me pajisje mjekësore, ku ligjërisht secila qendër duhet të jetë e pajisur me EKG, kurse qendrat tjera në qytet duhet të kenë edhe ultrazë.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** - duke iu referuar kërkesës së banorit të fshatit Sllatinë, ceku se ajo rrugë duhet të ndërtohet, si dhe apeloj që mos të kemi shpërndarje të projekteve mbi baza politike.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - sqaroi se rruga për në fshatin Tërllobuq, është rregulluar në dy pjesë, por ky projekt mund të konsiderohet i dështuar. Në këtë rast komuna i ka ndjekur procedurat ligjore, ku Gjykata themelore ka dhënë vendim pozitiv, kur rasti është duke u zhvilluar në instanca tjera gjyqësore, kështu që kompania e kontraktuar ka obligim t'i kthejë komunës shumën prej 70,000 €, të cilat do të përdoren për rregullimin e asaj rruge.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** - tha se projektet e rrugëve po dështojnë sidomos për shkak të cilësisë së dobët të materialit që përdoret për shtrimin e tyre dhe për shkak të mosrespektimit të paramasës ku nuk respektohet trashësia e zhavorrit. Andaj me këtë kërkoi nga menaxherët e projekteve dhe nga kryetari i komunës që të jenë të përpiktë në mbikëqyrjen e punimeve në terren.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – tha, ndërtimi i infrastrukturës së përgjithshme në komunën tonë është zhvilluar më shumë se sa në komunat tjera të Kosovës dhe shtoi se asnjë projekt nuk është orientuar mbi baza politike, dhe për këtë duhet të përgëzohet kryetari i komunës.

**Syzana Sylja, anëtare e kuvendit** – kërkoi që të bëhet rinovimi i tërësishëm i shkollës fillore “Naim Frashëri”.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – tha se rruga në fshatin Gumnishtë është shtruar aty ku nuk ka qenë në projekt, ku nuk ka banorë, në drejtim të fshatit Bare, por nuk është bërë rruga në lagjen “Ismjali” ku banojnë pesë familje. Mandej ajo kërkoi që të futet në projekt rruga në fshatin Brusnik ku lidhet lagja “Muzaqi” me fshatin Novolan-Bukosh deri në Vushtrri.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – tha se për çështjen e rrugës se fshatit Sllatinë, grupi kuvendar i LDK-së e ka ngritur disa herë këtë çështje, kurse lidhur me kualitetin e shtrimin të asaj rruge apeloj te inspektorati që ta inspektojë këtë rrugë që ky projekt të përfundojë me sukses.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** - tha se nuk dëshiron të bëjë fushatë elektorale, por në realitet PDK në Vushtrri si parti në pushtet tash e sa vite ka punuar mjaft shumë në përmirësimin e jetës së qytetarëve tanë.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – tha se është shumë e nevojshme që të rregullohet rruga në fshatin Tërllobuq pasi ajo rrugë më herët është dëmtuar në masë të madhe dhe ceku se tani ajo rrugë ka një bazë të mirë andaj apeloj që ky projekt të zhvillohet sa më parë dhe të përfundohet suksesshëm.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – duke iu referuar anëtarit të kuvendit Mentor Ferizi, vlerësoi se është e papranueshme fryma e të bërit fushatë në foltoren e kuvendit dhe apeloj tek kryesuesi i kuvendit që mos të lejojë një gjë të tillë.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – përsëriti se nga eksploatimi i zhavorrit në fshatin Pasomë, janë duke u shkaktuar pasoja të rënda për shkak të pluhurit që po bëhet dhe dëmet janë si për njerëz ashtu edhe për kulturat e ndryshme bujqësore. Andaj ai apeloj që rruga e mbetur prej afro 1 km të shtrohet me qëllim që të pamundësohet pluhurosja.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota “për” 1 votë “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim aprovet Korniza Afatmesme Buxhetore 2018-2020 e Komunës së Vushtrrisë, konform Qarkores Buxhetore 2018/01 e lëshuar nga Ministria e Financave me të cilën caktohen kufijtë buxhetorë të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018-2020.**

**2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

### **3.Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit dhe nënshkrimit nga kryesuesi i kuvendit.**

3.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** – paraqiti sqarime hyrëse lidhur me propozim-vendimin në fjalë.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se duhet të jepen sqarime lidhur me këtë propozim për këmbimin e pronës, për faktin se në KPF- është thënë se me këtë çështje do të merret ministria dhe se kjo çështje është tërësisht e paqartë.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se këmbimi i këtyre pronave do t'i shërbejë nevojave të komunës dhe apeloj që ky propozim të aprovohet.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 22 vota “për” 4 vota “kundër” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim Komuna e Vushtrrisë bën këmbimin e pronës së paluajtshme, parcela kadastrale P-70202016-02214-5, në sipërfaqe prej 155 m<sup>2</sup>, zona kadastrale Vushtrri, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me pjesë të parcelës kadastrale P-70202016-03953-0, në sipërfaqe prej 155m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 2281 m<sup>2</sup>, zona kadastrale Vushtrri, pronë e Beqir (Sheqir) Vërshevcit nga Vushtrria.

2.Këmbimi i pronave, të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të sigurimit të hapësirës për rikonstruimin e rrugës nacionale M2 Nedakoc-Smrekonicë.

3.Obligohet Kryetari i Komunës që në afat prej pesë (5) ditësh, pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës, të bëjë kërkesë në Ministrinë e Financave-ZVPP-së për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të cilat janë objekt i këmbimit, si dhe të lidhë kontratë për këmbimin e pronave me pronarin e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4.Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë paralizimin e ngastrave kadastrale në sipërfaqen e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

4.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për shndërrim të projektit “ndërtimi i kanalizimeve” në projekt dyvjeçar dhe përcaktimi i vijave të ndërtimit të kanalizimeve

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – pyeti se cilat projekte janë për vitin 2017, të cilat ai nuk i di, andaj kërkoi që kjo çështje të sqarohet. Pastaj ai vlerësoi se shpërndarja e këtyre projekteve nuk është reale në kuptimin e orientimit të këtyre projekteve, prandaj kërkoi që mjetet e përcaktuara për kanalizime të shpenzohen në këtë vit si projekte njëvjeçare, kurse gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2018 të futen edhe projekte tjera. Lidhur me orientimin e projekteve të kanalizimit ai propozoi që kanalizimit Gllavatin-Stroc t'i shtohen edhe 1300 m gjatësi të rrjetit të kanalizimit, në fshatin Gllavatin 600 m, në fshatin Zhilivodë 1400 m, Beçuk 1500 m.

**Selvete Sholla, anëtare e kuvendit** – tha se kemi shumë probleme me rrjetin e kanalizimit në lagjen tek “Banesat e bardha” ku ka pasur edhe vërshim nëpër shtëpi dhe oborre, por pasojat janë evituar në saje të ndihmës së kompanisë së ujësjellësit. Në këtë kontekst kërkoi nga

Drejtoria e Shërbimeve Publike që të bëhet ndërrimi i gypave të kanalizimit në lagjen tek “Banesat e bardha”, për faktin se gypat ekzistues nuk e përballojnë sasinë e ujit sepse janë shumë të ngushtë ku shumë ndërtesa të reja janë kyçur në këtë kanalizim dhe ky rrejt nuk e përballon këtë sasi të ujit. Në fund propozoi që rrjeti i kanalizimit në gjatësi prej 600 m në vendin e quajtur tek “Banesat e bardha” të futet si projekt në këtë propozim-vendim.

**Syzana Sylja, anëtare e kuvendit** – tha se tek pika 1.9 kanalizimi në fshatin Druar, vazhdimi tek shkolla e fshatit Mihaliq lagjja “Prekaj” në rrugën ku ndahet lagjja “Syla” janë vendosur gypat e ngushtë, ku gjatë reshjeve atmosferike atypari proocka del nga shtrati e në këtë rast shkaktohen shumë dëme në shtëpitë përreth, por edhe në pronat bujqësore. Kurse tek stacioni i kombi-taksive në fshatin Mihaliq kërkoi që të futen 600 metra rrejt i kanalizimit.

**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – propozoi që të shtrihet rrejt i kanalizimit në lagjen “Nezir Imeri” rr. “Shote Galica” në gjatësi 350m.

**Arta Ismajli, anëtare e kuvendit** – i përkrahi propozimet e anëtarit të kuvendit Habib Mustafa, si dhe propozimin që të intervenohet në rregullimin e kanalizimit në rrugën “Skënderbeu” tek vendi i quajtur “Banesat e bardha”.

**Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit** – propozoi që të shtrihet rrejt i kanalizimit në Vushtrri rr. “Mustafë Çuka” në gjatësi prej 300 m.

**Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit** - propozoi që të shtrihet rrejt i kanalizimit në fshatin Pasomë në gjatësi prej 3000 m.

**Safet Idrizi, anëtar i kuvendit** – propozoi që të shtrihet rrejt i kanalizimit në rr. “Helge Onsrud” në gjatësi prej 400 m.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – propozoi që të shtrihet rrejt i kanalizimit në rr. e Sllatinës në gjatësi prej 200 m.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – propozoi që të rregullohet kanalizimi në fshatin Gracë i cili është në gjendje jo të mirë, si dhe propozoi që të shtrihet rrjeti i kanalizimit në gjatësi prej 200 m në rr. “Muzafer Muhaxheri” në fshatin Stanoc i Poshtëm.

**Bajram Mulaku, Kryetar i Komunës** - tha se duhet të bëhet gjithçka që është e mundur që të fillohet me trajtimin e ujërave të zeza, për faktin se nga ujërat fekale kemi ndotje enorme të lumit “Silnica” dhe kjo do të mund të bëhet përmes ndërtimit të impianteve. Mandej njoftoi se është duke vazhduar shtrimi i rrjetit të ujësjellësit, por si problem është shfaqur çështja e kyçjeve individuale të ekonomive familjare, por edhe të bizneseve në rrjetin e ujësjellësit. Këtë problem ndërmarrja nuk ka mundësi dhe kapacitet profesional dhe material që ta zgjedh. Pastaj ceku se në bazë të analizave profesionale që janë bërë, nevojiten rreth 1 milion euro vetëm për kyçje individuale në rrjetin e ujësjellësit. Nëse insistohet që konsumatorëve t’u merren para në vlerë prej 120 €, atëherë këto kyçje do të jenë joprofesionale dhe teknikisht jo të rregullta. Andaj për këtë do të ishte mirë që të zhvillohej një projekt për zgjidhjen më të mirë të duhur të kësaj problematike. Në fund tha se vlera prej 270,000 € nuk është e mjaftueshme për realizimin e të gjitha kërkesave për shtrirjen e rrjetit të kanalizimit.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – propozoi që të shtrihet rrejt i kanalizimit në lagjen “Dauti” në fshatin Pasomë në gjatësi prej 200 m, pasi që gjendja e ujërave të zeza në këtë lokalitet është shumë e rëndë.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – pyeti kryetarin e komunës se nga fshati Kollë e deri në fshatin Stroc nuk është shtrirë rrjeti i ujësjellësit, andaj kur do të shtrihet ky rrejt.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se rrjeti i ujësjellësit është duke u shtrirë në dy pjesë, njëra me gypin magjistrat, përgjatë hekurudhës deri në pikën sa uji bartet me rënie të lirë, kurse pjesa tjetër do të bëhet nga rezervari i cili ndodhet në fshatin Taraxhë.

**Nexhat Merovci, zyrtar në Drejtorinë e Urbanizmit** - paraqiti sqarime lidhur me zhvillimin e projektit në rrugën e fshatit Sllatinë. Pastaj njoftoi se ujësjellësi në fshatrat e Artakollit do të bëhet përmes hidro-pompave.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se duhet të intervenohet në rregullimin e shtratit të lumit “Podranqa”, për faktin se në gjendjen çfarë ndodhet ai paraqet rrezik për qytetarët sidomos atyre që banojnë përgjatë këtij lumi.

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se pasi që ka shumë kërkesa për ndërtimin e rrjeteve të kanalizimit, atëherë ai kërkoi që të gjitha këto kërkesa të futen në propozim-vendim, dhe që këto projekte të bëhen trivjeçare.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim projekti “ndërtimi i kanalizimeve” i vitit 2017 (programi 0451, kodi i projektit 41415) shndërrohet në projekt trevjeçar për vitet 2017-2019.

2.Lejohet ndërtimi i kanalizimeve në këto lokalitete:

- 2.1 Kanalizimi atmosferik në rr. „Basri Beqiri” (te komuna e re) L=210 m;
- 2.2 Kanalizimi në rr. „Nexhip dhe Ferat Draga” L=450 m;
- 2.3 Kanalizimi në rr. „Faruk Beqiri” L=550 m;
- 2.4 Kanalizimi në fshatin Banjskë, Sfaraçak dhe Nedakoc L=4485 m;
- 2.5 Kanalizimi në fshatin Pantinë lagjja e Karaçëve L=350 m;
- 2.6 Kanalizimi prapa objektit të shkollës “Ali Kelmendi” L=250 m;
- 2.7 Kanalizimi te Ura e vjetër e gurit (kolektori kryesor) L=1155 m;
- 2.8 Kanalizimi në fshatin. Samadrexhë (kolektori kryesor), Dumnicë, L=8260 m dhe fshatin Pestovë L=1650 m;
- 2.9 Kanalizimi në fshatin Druar, vazhdimi te shkolla, fshati Mihaliq lagjja „Prekaj” - te hekurudha L= 3650 m;
- 2.10 Kanalizimi në fshatin Gllavatin – Stroc L=3020 m;
- 2.11 Kanalizimi në fshatin Bivolak L=976m;
- 2.12 Kanalizimi në fshatin Pantinë te shkolla, lagjja “Ismajli-Kamberi-Kolludra-Imeri”, rruga për Ashlan L=2315 m;
- 2.13 Kanalizimi në fshatin Bukosh dhe pjesa te hekurudha L=1250 m;
- 2.14 Kanalizimi në fshatin Kollë, kolektori kryesor në Brusnik, Novolan L=4250 m.
- 2.15 Kanalizimi në fshatin Zhilivodë L=1400 m.
- 2.16 Kanalizimi në fshatin Beçuk L=1500 m.
- 2.17 Kanalizimi në fshatin Gllavatin L= 600 m.

- 2.18 Kanalizimi në fshatin Pasomë lagjja “Dauti” L= 200 m.
- 2.19 Kanalizimi në lagjen “Nezir Imeri” rrugua “Shotë Galica” L= 350 m.
- 2.20 Kanalizimi në Vushtrri rruga “Mustafë Çuka” L=300 m.
- 2.21 Kanalizimi në fshatin Pasomë – Banjskë L= 3000 m.
- 2.22 Kanalizimi në rrugën “Helge Onsrud” L= 400 m.
- 2.23 Kanalizimi në rrugën e “Sllatinës” L=250 m.
- 2.24 Kanalizimi në fshatin Stanoc i Poshtëm rruga “Muzafer Muhaxheri” L=200 m.
- 2.25 Kanalizimi në rrugën “Vicianà”, nga stacioni i trenit në drejtim të qytetit të Vushtrrisë L=770 m.
- 2.26. Kanalizimi në rrugën “Hamdi Gashi”, vendi i quajtur “Banesat e bardha” L=600 m.
- 2.27 Kanalizimi në fshatin Mihaliq, Rr.”Rezistenca”L=600 m.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Drejtoria për Shërbime Publike.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për ndarjen e mjeteve për realizimin e projektit për ndërtim të shtëpisë për banim nga kategoria për subvencione dhe transfere në bashkëfinancim me SHBK “Nëna Terezë”

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se kjo shtëpi do të ndërtohet nga fondi për transfere dhe subvencione pozicioni “financimi me bashkëdonatorë” kurse shtëpia do të ndërtohet në fshatin Bukosh.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:**

**1. Me këtë vendim bëhet ndarja e mjeteve për realizimin e projektit për ndërtim të shtëpisë për banim për z. Mentor Hajrullahun nga fshati Kollë, nga kategoria për subvencione dhe transfere, kodi ekonomik “Bashkëfinancim me donatorë” në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, në bashkëfinancim me SHHBK “Nënë Tereza”.**

**2. Ndërtimi i shtëpisë i cekur në pikën 1 të këtij vendimi do të bëhet në fshatin Bukosh, Komuna e Vushtrrisë.**

**3. Shuma e ndarë për këtë projekt si pjesë e bashkëfinancimit nga Komuna e Vushtrrisë, është një mijë e pesëqind euro (1.500 €).**

**4. Autorizohet Kryetari i Komunës për nënshkrimin e marrëveshjes me SHHBK “Nënë Tereza” për bashkëfinancimin e ndërtimit të shtëpisë për banim.**



**5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.**

6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së** - paraqiti sqarime hyrëse para anëtarëve të kuvendit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota “për” të tjerat “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Lejohet ndërrimi i destinimit nga toka bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale: nr.P-70202003-00005-0, me kulturë arë e klasës së gjashtë (6), në sipërfaqe prej 2883m<sup>2</sup>, zona kadastrale Banjskë, pronë e Edmond (Ali) Hasanit me vendbanim në fshatin Banjskë Komuna Vushtrri.

2. Qëllimi i lejimit të ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelën kadastrale të cekur si në pikën 1 të këtij vendimi, është ndërtimi i objektit të fabrikës për riciklim të vajit dhe ndërtimi i objektit i fabrikës së zogjve.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika 2 e këtij vendimi do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 nën ”b” të Udhëzimit Administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr.41/2006, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet: Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

7. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** – paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se bëhet fjalë për këmbimin e pronave mes komunës, bashkësisë islame për nevojat e komunës për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se kuvendi i komunës ka përgjegjësi që ta ruaj tokën e komunës, andaj me këtë drejtoria kompetente a ka shikuar se sa xhamia janë në pronë të komunës dhe pikërisht me këto prona do të mund të këmbehen pronat që janë të nevojshme për komunën. Gjithashtu ai kërkoi informatë për numrin e xhamive që janë ndërtuar në tokë komunale që të kemi një pasqyrë të saktë për këmbimin e pronave me bashkësinë islame.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se më herët është thënë që kjo pronë ishte dhuruar nga bashkësia islame, kurse tani propozimi ka ardhur për këmbim, andaj këtu ekziston një paqartësi e cila duhet sqaruar. Pastaj pyeti se a ka marrëveshje me Këshillimin e bashkësisë islame për këmbimin e këtyre pronave, për faktin se më vonë mund të dalin probleme tjera.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 20 vota "për" të tjerat abstenim vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim Komuna e Vushtrrisë bën këmbimin e pronës së paluajtshme, pjesë nga parcela kadastrale P-70202021-00423-0 dhe P-70202021-00424-0, ZK Prronaj në sipërfaqe që do të caktohet pas vlerësimit nga organi kompetent, pronë e Komunës së Vushtrrisë, me pjesën e parcelës kadastrale P-263, tab.149, fletëtreguesi nr.46, në sipërfaqe prej 1000m<sup>2</sup>, nga sipërfaqja e përgjithshme prej 16043m<sup>2</sup> zona kadastrale Banjskë, pronë e Bashkësisë Islame në Vushtri me seli në Vushtri.

2.Këmbimi i pronave të cekura në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të sigurimit të hapësirës për ndërtimin e objektit të Qendrës të Mjekësisë Familjare në fshatin Banjskë.

3.Obligohet Kryetari i Komunës që në afat prej pesë (5) ditësh, pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Komunës, të bëjë kërkesë në Ministrinë e Financave-ZVPP-së për vlerësimin e pronave të paluajtshme, të cilat janë objekt i këmbimit, si dhe të lidhë kontratë për këmbimin e pronave me pronarin e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

4.Obligohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi të bëjë paralizimin e ngastrave kadastrale në sipërfaqen e cekur në pikën 1 të këtij vendimi.

5.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

8.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e sheshit "Azem dhe Shotë Galica" në Vushtri

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, duke shtuar se sheshi është rregulluar me kontributin e komunës dhe ideja është që ky shesh të emërtohet me emrat e këtyre figurave kombëtare "Azem dhe Shotë Galica".

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – tha se në arsyetimin e këtij propozimi thuhet që Kryetari i komunës në bashkëpunim me këshillin e drejtorëve kanë vendosur që të emërtojnë këtë shesh dhe nëse veç kjo çështje është vendosur, atëherë s'ka nevojë që të deklarohet fare kuvendi, andaj në këtë rast kërkoi që të bëhet përmirësimi i këtij gabimi.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – tha se pjesa e dispozitivit dhe arsyetimi i këtij propozim-vendimi kanë kundërthënie, andaj kjo çështje duhet të sqarohet para se të votohet.

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së** - tha se nuk duhet të lëshohem në çështje e arsyetimit të këtij propozimi pasi që kemi të bëjmë me dy figura kombëtare që nuk janë kontestuese dhe propozoi që ky propozim të aprovohet me unanimitet të plotë.

**Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit** – vlerësoi se nuk është kundër këtij propozimi për emërtimin e këtij sheshi, por ceku se duhet të kemi respektim të anës formale-juridike dhe pajtueshmëri mes dispozitivit dhe arsyetimit të vendimit.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – përsëriit se nuk janë kundër emërtimit të këtij sheshi, dhe nuk duhet të ketë keqkuptim, por vetëm duhet të bëhen përmirësimet e kërkuara.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim aprovohet emërtimi i sheshit me emrin "Azem dhe Shotë Galica" në Vushtri.

2. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

3. Ky Vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

9. Shqyrtimi i Informatës lidhur me inspektimin e bizneseve në Komunën e Vushtrrisë

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – ngriti një shqetësim i cili i është adresuar nga ana e qytetarëve, ku në sheshin e qytetit janë dhënë lejet për shfrytëzimin e hapësirave në sheshe nga lokalet e ndryshme, në ç' rast tavolinat që janë vendosur nga lokalet po i bllokojnë hyrjet e banesave dhe kështu po shkaktojnë pengesa në hyrje-daljet e banorëve. Andaj në këtë rast kërkoi nga Drejtoria e Inspektimeve që të ndërmarrë masa lidhur me më këtë problematikë.

10. Shqyrtimi i Informatës për shfrytëzimin e pasurisë së komunës

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – kërkoi të jepen sqarime nga kompetentët lidhur me vendparkimin e automjeteve që barten me automerimangë.

**Bedri Dobra, drejtor i DGJKP-së** – dha sqarime për anëtarin e kuvendit.

**Shkelzen Feka, anëtar i kuvendit** – tha se kjo informatë duhet të plotësohet edhe me të dhëna të tjera, me sipërfaqen e pronave të dhëna në shfrytëzim dhe me kontratat, të cilat i ka lidhur komuna me shfrytëzuesit e këtyre pronave dhe me vlerën e kompensimit. Mandej në informatë nuk jepen të dhëna për pronat e uzurpuara dhe për veprimet e ndërmarra për lirimimin e këtyre pronave. Andaj kjo informatë përshkruan vetëm të dhëna të përgjithshme dhe si e tillë ajo duhet të jetë më e konkretizuar.

11. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e lokacioneve për ndërtimin e shtëpive në komunitet

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se këto shtëpi do të ndërtohen në fshatra që në numër llogaritet se janë 50 sosh, andaj autorizohet Drejtoria e Kadastrit, që të identifikojë parcelat ku do të ndërtohen këto shtëpi.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se e përkrahin plotësisht këtë propozim dhe ceku se kjo iniciativë duhet të përcillet edhe me një rregullore.

**Ali Januzi, anëtar i kuvendit** – tha se kishte me qenë mirë që këto objekte të emërtohen si shtëpi të kulturës, ku në këto qendra do të zhvilloheshin aktivitete kulturore nga rinia jonë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 26 vota “për” 1 votë “abstenim” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim autorizohet Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, që të bëjë identifikimin e parcelave, të cilat janë në pronësi komunale, në të cilat do të ndërtohen shtëpi në komunitet.

2. Qëllimi i ndërtimit të këtyre shtëpive është qëndrimi ditor në rastet e vdekjeve dhe riteve tjera, të banorëve të atyre lokaliteteve ku do të ndërtohen këto shtëpi.

3. Ndërtimi i këtyre shtëpive do të bëhet me vetëfinancim nga banorët e lokaliteteve ku do të ndërtohen ato shtëpi apo nga ndonjë donator.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit.

b). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se e përgëzon kryetarin e komunës që ka propozuar një vendim të tillë dhe është i kënaqur që kjo ide e bërë vite më parë nga ana e tyre po jetësohet. Në këtë kontekst vlerësoi se shpreson që ky vendim nuk po merret për fushatë elektorale dhe gjithashtu shpreson se i njëjti do të gjen zbatim.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se ky propozim është hartuar dhe përkrahur nga subjekti i tij politik, por ai deklaroi se për këtë i ka rezervat e tij dhe këtë për dy arsye sepse shumica e subvencioneve është shumë e vogël, kurse nevojat shumë të mëdha. Mandej ai vlerësoi se shumica prej 80 mijë për shpenzime të varrimit për qytetarët nuk është e mjaftueshme, por kjo kosto duhet të jetë më e lartë. Në këtë relacion ai ndan mendimin që kjo pagesë të bëhet në mënyrë parciale për raste më sociale.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 28 vota “për” vendosi me sa vijon:**

1. Me këtë vendim bëhet pagesa e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e Komunës së Vushtrrisë nga ana e komunës.

2. Obligohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa që gjatë fazës së planifikimit të buxhetit të komunës për vitin 2018 të përcaktojë koston financiare të pagesës së këtyre shpenzimeve dhe që këto shpenzime të inkorporohen në buxhetin e Komunës së Vushtrrisë për vitin 2018.

3. Mjetet financiare për mbulimin e shpenzimeve të cekura në pikën 1 të këtij vendimi do të sigurohen nga kategoria mallra dhe shërbime, nënkategoria “shpenzimet e varrimit”.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

5. Ky vendim fillon të prodhojë efekte juridike nga data 01.01.2018.

c). Shqyrtimi i petitionit të banorëve të fshatit Bukosh

**Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit** – tha se kuvendi i komunës nuk ka kompetencë ligjore që të merret me mbylljen e lokaleve dhe i rekomandoj Drejtorisë së Inspektimeve që konform ligjeve pozitive t'i ndër marrë masat adekuate ligjore.

**Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:**

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë në mbledhjen e mbajtur më datë 29 qershor 2017, pas shqyrtimit të petitionit të banorëve të fshatit Bukosh, lidhur me mbylljen/largimin e lokalit (kafesë së rakisë) në këtë fshat, Drejtorisë për Inspektime ia parashtron këtë:

## REKOMANDIM

Kuvendi i Komunës së Vushtrrisë i rekomandon Drejtorisë për Inspektime që për rastin në fjalë të bazohet në suazat ligjore të Ligjit për Tregtinë e Brendshme, Rregulloren për Orarin e Punës të Bizneseve dhe në aktet tjera të nxjerra nga Kuvendi i komunës dhe nga niveli qendror.

*Gjithashtu Kuvendi kërkon nga Drejtoria për Inspektime që banorët e këtij fshati parashtrues të peticionit, të njoftohen me shkrim për shqyrtimin e peticionit nga ana e Kuvendit të komunës, si dhe për të gjitha veprimet e ndërmarra nga ana e drejtorisë lidhur me çështjen në fjalë.*

ç). Shqyrtimi i Propozim-vendimit për emërtimin e rrugës me emrin e Zeqir Gubetinit

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së** - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës para anëtarëve të kuvendit.

**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – propozoi që mos të bëhet ndryshimi i emërtimit të këtyre rrugëve pasi që edhe në diskutimin publik është vendosur që rruga të ketë emrin Sadri Maksuti nga varrezat e fshatit deri në rrugën kryesore, kurse rruga Besim e Milaim Muhaxheri të jetë nga mulliri deri tek fshati Prelluzhë.

**Sami Istrefi, drejtor i DUMM-së** - tha se propozimi i bërë nga ana e drejtorisë ka qenë me qëllimin më të mirë që të ketë marrëveshje dhe t'i shmangemi konfliktit eventual të familjeve.

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – tha se kjo çështje duhet të precizohet saktë me qëllim që t'u shmangemi konflikteve eventuale mes familjeve.

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se me procesin e emërtimit të rrugëve është munduar të bëhet një punë e madhe, por kjo nuk nënkupton që nuk ka pasur edhe lëshime gjatë këtij procesi. Në këtë kontekst ai vlerësoi se për këtë çështje është dashur që të themelohet një komision profesional nga fusha të ndryshme dhe jo të bëhen emërtime sipas shfrytëzimit të ndikimit.

**Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit me 18 vota "për" të tjerat "abstenim" vendosi me sa vijon:**

1.Me këtë vendim aprovohet kërkesa për formimin e një rruge të re dhe emërtimi i saj me emrin e patriotit të shquar të çështjes kombëtare "Zeqir Gubetini" në fshatin Nedakoc. Kjo rrugë lidh rrugët "Lumni Surdulli" dhe " Ismajl Gubetini ", ndërrimi i vendit të emrit të rrugës "Milaim e Besim Muhaxheri" në fshatin Stanoc i Poshtëm dhe vendosja në rrugën "Sadri Maksuti" pra rruga "Sadri Maksuti" ndahet në dy pjesë në njërin pjesë mbetet emri i "Sadri Maksutit" pjesa që lidhet me rrugën "Viliam Voker" (magjistrale), pjesa tjetër në vazhdim i bartet emri i cekur më lart "Milaim e Besim Muhaxheri"

2.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Shërbime Publike dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.

d). Shqyrtimin i Propozim-vendimit për ndërtimin e lapidarit të UÇK-së në fshatin Stroc

**Bajram Mulaku, Kryetar i komunës** - tha se ka menduar si kryetar i komunës që këtë proces ta shtyjë përpara, por më vonë ka parë që ka pasur mospajtime mes banorëve lokal. Në këtë

kontekst ai vlerësoi se duhet të gjendet një marrëveshje mes palëve dhe të bëhet ndërtimi i atij lapidari. Lidhur me këtë çështje ai apeloj që të gjendet një zgjidhje mes ish-udhëheqësve të UÇK-së të Brigadës 142 për përcaktimin e lokacionit dhe që ky projekt të përfundojë.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – tha se nga një takim që është mbajtur është vendosur për lokacionin e ndërtimit të këtij lapidari. Kjo çështje është votuar dhe me unimitet është vendosur që lokacioni për ndërtimin e këtij lapidari të jetë tek “Ura e Gllavatinit” në fshatin Gllavatit. Në fund tha se kanë ndodhur disa ngatërresa dhe keqkuptime sa i përket kësaj çështjeje dhe apeloj që kjo çështje të vendoset nga ana e kuvendit.

*Në fund kuvendi në mënyrë unanime vendosi që të mbahet një takim me komisionin kuvendar me banorët lokal dhe me ish-udhëheqësit e UÇK-së të Brigadës 142 të ZOSH, me qëllim që të gjendet një zgjidhje sa i përket caktimit të lokacionit për ndërtimin e lapidarit për Baltonin e –I - të Brigadës 142 të UÇK-së.*

**dh).** Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

**Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga kryetari i komunës, që të angazhohet dhe të kërkojë nga organet e sigurisë, që të ngritët siguria në rr.”Pandeli Sotiri”, ku frekuentojnë shumë njerëz sidomos nga ora 19:00-24:00, ku ndodhen shumë kafiteri dhe shpeshherë kemi edhe rrahje dhe konsumim të substancave narkotike nga të rinjtë. Andaj për këtë vlerësoi që duhet të kërkohet nga policia që të kemi patrulla policore në këtë lokalitet. Gjithashtu vërejtja tjetër ishte se tek stadiumi i gomës, shumë të ri marrin substanca narkotike dhe apeloj që policia të ketë masa shtesë në atë vend.

**Habib Mustafa, anëtar i kuvendit** – ngriti çështjen e lypësve në qytet, ku kërkoi të dihet se ata a janë në të vërtetë skamnorë apo prapa tyre qëndron dikush që i shtyn në këtë aktivitet. Në këtë kontekst shtoi se disa persona të organizuar dalin në qytet dhe i ndalin qytetarët duke iu kërkuar mjete financiare për siç thonë ata për ofrimin e ndihmës peronave të caktuar dhe për këtë pyeti se këta persona a janë të autorizuar për ta bërë një gjë të tillë. Çështja tjetër që ngriti është ajo e rrethrotullimit në hyrje të qytetit i cili po shkakton shumë pengesa në komunikacion, për këtë pyeti se kur do të përfundohen punimet në këtë rreth.

**Melihate Basholli, anëtare e kuvendit** – pyeti se a i është dal në ndihmë vajzës së Lulzim Brahimit, i cili ka kërkuar një ndihmë financiare në vlerë prej 400 €, me qëllim të shërimit të vajzës së tij.


**Isa Hajrizi, anëtar i kuvendit** – pyeti se përse në fabrikën e riciklimit mungon sigurimi dhe pajisjet, por edhe oborri i kësaj fabrike nuk pastrohet.

**Agron Përçuku, anëtar i kuvendit** – kërkoi nga DSHP-ja që në rr.”Marin Barleti” të zhbllokohet ku një shtëpi e një pjesëtari të komunitetit rom është rrënuar dhe kjo po i shkakton pengesa bizneseve përreth, por edhe kalimtarëve të rastit.


**Rrahim Ajeti, anëtar i kuvendit** – pyeti se kur do të përfundohet lapidari për dy dëshmorët e viteve 90-ta, Sadri Maksutin dhe Sadik Malën.

**Mbledhja përfundoi në orën 14:30.**

**Bastri Duraku**

  
\_\_\_\_\_  
**Procesmbajtës**

**Shpëtim Zhegrova**

  
\_\_\_\_\_  
**Kryesues i Kuvendi**